

Prof. Dr. Antonio Belushi (Bellusci)*

QEMAL HAXHIHASANI DHE BOTA ARBËRESHE NË ITALI

(Nga letërkëmbimi me etnologun A. Belushi)

Njohja e Qemal Haxhihasanit

Qemal Haxhihasani, mbledhës dhe studiues i folklorit dhe i dialektologjisë, filolog dhe profesor, lindi në Elbasan⁽¹⁾. Shumë të vlefshme janë botimet e tij mbi folklorin shqiptar⁽²⁾.

Haxhihasanin e kam njohur personalisht në Tiranë, kur u mbajt Kuvendi Ndërkombëtar mbi Ilirët, më 15-16 shtator 1972, ku ka qenë ai i ftuar për një kumtesë, gjithashtu edhe unë, si prift dhe studiues arbëresh⁽³⁾. Në ato ditë dhe më vonë kam njohur dhe biseduar vëllazërisht edhe me disa profesorë dhe akademikë si

* Antonio Belushi (Bellusci) lindi në Frascineto/Frasnitë (Cosenza) më 15 shtator 1934. Prift arbëresh me shtetësi shqiptare. Doktor Honoris Cauza në etnologji nga Akademia e Shkencave, Tiranë; Medalja e Artë e Lidhjes e Prizrenit. Etnolog, gazetar, shkrimtar, ka botuar 13 vepra etnologjike mbi arbëreshët dhe mbi arbërorët. Ka themeluar revistën "Vatra jonë (1966), revistën "Lidhja"(1980), dhe Bibliotekën Ndërkombëtare Shqiptare në Frasinë, që ai e drejton edhe sot.

¹ A. Xhagolli, *Qemal Haxhihasani*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. II, Tiranë 2008, 895.

² Q. Haxhihasani, *Këngë popullore legjendare*, Tiranë 1955; id., *Këngë popullore historike (1878-1912)*, Tiranë 1962; id., *Folklor shqiptar*, v. I, Tiranë 1966; idem, v. II, Tiranë 1983; id., *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun*, Tiranë 1967; id., *Thimi Mitko - Vepra*, Tiranë 1981; idem, *Ballada popullore shqiptare*, Tiranë 1982; id., *Zihni Sako - Studime për folklorin*, Tiranë 1984.

³ A. Bellusci, *Convegno Intrenazionale sugli Illiri a Tirana*, Zgimi/Risveglio, Marri, 2, 1972, 27-32; Id., *Importante convegno a Tirana*, Zëri i Arbëreshëvet, Ejanina, 4, 1972, 36-38; id., *Arbëreshët dhe lidhjet me ilirët*, Studime filologjike, Tirana, 3, 1973, 147-154.

Eqrem Cabej⁽⁴⁾, Stefanaq Pollo⁽⁵⁾, Aleksandër Buda⁽⁶⁾, Androkli Kostallari⁽⁷⁾, Shaban Demira⁽⁸⁾j, Zihni Sako⁽⁹⁾, Emil Lafe⁽¹⁰⁾, Jorgo Bullo⁽¹¹⁾, Beniamin Kruta⁽¹²⁾, Gjovalin Shkurtaj⁽¹³⁾, Floresha Dado⁽¹⁴⁾, Jorgji Gjinari⁽¹⁵⁾, Agron Xhagolli⁽¹⁶⁾, Mark Tirta⁽¹⁷⁾Ali Xhiku⁽¹⁸⁾, Mahir Domi⁽¹⁹⁾, Valentina Duka⁽²⁰⁾, Neritan Ceka⁽²¹⁾, Pëllumb

⁴ Mahir Domi, *Eqrem Çabej* (1910-1993), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v.I, Tiranë 2008, 369.

⁵ Kristaq Prifti, *Stefanaq Pollo* (1923-1997), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v.III, Tiranë 2009, 2063.

⁶ Kristaq Prifti, *Aleksandër Buda* (1918-1993), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v.I, Tiranë 2008, 315.

⁷ Jani Thomai, *Androkli Kostallari* (1922-1992), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. II, Tiranë 2008, 1324.

⁸ Seit Mansaku/Enver Hysa, *Shaban Demiraj* (1920 -), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. I, Tiranë 2008, 442.

⁹ Qemal Haxhihasani, *Zihni Sako* (1912-1981), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. III, Tirana 2009, 2292.

¹⁰ Enver Hysa, *Emil Lafe* (1938 -), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. II, Tiranë 2008, 1448.

¹¹ Floresha Dado, *Jorgo Bullo* (1939 -), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. I, Tiranë 2008, 328.

¹² Pirro Miso, *Beniamin Kruta* (1940-1994), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. II, Tiranë 2008, 1364.

¹³ Enver Hysa, *Gjovalin Shkurtaj*, (1943 -), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. III, Tiranë 2009, 2501.

¹⁴ Kristaq Jorgo, *Floresha Dado*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. III, Tiranë 2009, 3030.

¹⁵ Enver Hysa, *Jorgji Gjinari*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. I, Tiranë 2008, 842.

¹⁶ Afërdita Onuzi, *Agron Xhagolli*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. III, Tiranë 2009, 2943.

¹⁷ Babi Ruci, *Mark Tirta*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. III, Tiranë 2009, 2715.

¹⁸ Ymer Çiraku, *Ali Xhiku*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. III, Tiranë 2009, 2953.

¹⁹ Enver Hysa, *Mahir Domi* (1915-2000), Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. I, Tiranë 2008, 504.

²⁰ Hysen Kordha, *Valentina Duka*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. I, Tiranë 2008, 541.

²¹ Muzafer Korkuti, *Neritan Ceka*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. II, Tiranë 2008, 358.

Xhufi⁽²²⁾. Edhe shumë profesorë shqiptarë të tjerë kanë ardhur tek biblioteka ime në Frasnitë dhe kanë shkruajtur mendimet dhe emocionet e tyre në regjistrin e vizitorëve⁽²³⁾.

Ndodhi kështu, sepse kur botova librin “Argalia ndër tekstet origjinale arbëreshe”⁽²⁴⁾, i dërgova një kopje edhe Haxhihasanit. Ky e analizoi dhe shkroi një recension shumë të gjatë dhe të bukur, që e përfundonte kështu:

“Materiale të tilla nga tërë shtrirjet e diasporës, ashtu si na jepen në këtë botim të A. Bellusci-t do të ndihmojnë për të ndjekur më mirë njësinë, origjinalitetin dhe zhvillimin e saj historik. Me to përmbushet nga studiuesit një detyrë sa patriotike aq edhe e mirëfilltë shkencore”⁽²⁵⁾.

Për herë të parë, në historinë e lidhjeve dhe të marrëdhënieve kulturore arbëreshe-shqiptare, një botim arbëresh mbi mjeshhtërinë e argalisë/vekut tërhiqte vëmendjen dhe admirimin e studiuesve etnologë shqiptarë. Mua m’u duk një eveniment historik, dhe m’hapi zemrën për bashkëpunime të tjera me vëllezërit shqiptarë. Haxhihasani, për këtë recension, mori edhe çmimin e parë nga redaksia e revistës “Nëntori”.

Për mua ka qenë një moment i jashtëzakoshëm gëzimi dhe nderimi. Shkrimi i Haxhihasanit më nxiti më shumë të vazhdoja në kërkimet e mia në fushën e kulturës popullore arbëreshe në

²² Hysen Kordha, *Pëllumb Xhufi*, Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. II, Tiranë 2008, 2957.

²³ A. Bellushi, *Gjurmë dhe realitete emocionale – Vizita, kujtime, dëshmi në bibliotekën “A. Bellusci”*, Frasnita 2018. Në këtë botim janë afro 1500 dëshmi të shkruara nga studiuesit që kanë ardhur në bibliotekë. Është një monument me dokumente shpirtërore dhe kulturore që lartësojnë ndjenjat kombëtare shqiptare në botë.

²⁴ A. Bellusci, *Il telaio nei testi originali arbëreshë – Ricerca etnografica tra gli albanesi di Calabria, Basilicata e Grecia*, Cosenza 1977.

²⁵ Q. Haxhihasani, “Një botim i ri për kulturën popullore arbëreshe – Shënim për vëllimin “Argalia ndër tekstet origjinale arbëreshe”. *Nëntori*, Tiranë, 10, 1977, 218-221; Id., *Një botim i ri për kulturën popullore arbëreshe*, Jehona, Shkup, 8, 1977, 1024-1033; Id., *Një botim i ri për kulturën popullore arbëreshe*, Studia Albanika, Tiranë, 1, 1079, 1979, 203-207.

Itali⁽²⁶⁾, si edhe arbërore në Greqi⁽²⁷⁾. Një fushë e gjerë shekullore akoma e pazbuluar. Vlerësimi i këtyre dokumenteve gojore m'u duk një punë edhe më e madhe.

Në Prishtinë, më 15-30 gusht 1980, kam takuar personalisht edhe një tjetër herë Haxhihasanin, i cili kishte ardhur në seminarin e gjuhës dhe kulturës shqiptare bashkë me Prof. Shaban Demirajn, Prof. Mahir Domin dhe Prof. Jorgo Bulon. Dhe kështu miqësia jonë u bë edhe më e fortë, edhe më e ngushtë. Këshillat e tyre i vlerësova shumë në jetën time.

Gjatë ditëve që kaluam bashkë në Prishtinë shumë herë jemi mbyllur në një dhomë për të punuar bashkë, duke biseduar mbi kulturën gojore arbëreshe dhe arbërore.

Qemal Haxhihasani përpara meje ishte si një mjeshtër i madh, i pjekur dhe me dituri. Nga ai unë kërkoja këshilla dhe ndihmë mbi metodologjinë në mbledhjen e kulturës gojore, në transkriptimin, sistemimin, përkthimin dhe botimin e materialit.

Lidhja jonë vëllazërore vazhdoi duke i dërguar revistën gjashtëmujore "Lidhja", që themelova në Kozencë në vitin 1980, dhe botimet e mia të tjera etnografike. Haxhihasani më dërgonte revista dhe botime nga Shqipëria, që sot nderojnë dhe zbukurojnë bibliotekën time në Frasnitë, ku kanë ardhur shumë shkencëtarë shqiptarë për kërkime mbi kulturën dhe letërsinë arbëreshe⁽²⁸⁾.

Ndodhi që në shtator të vitit 1984 Qemali fillon dhe më shkruan letra me dorën e tij, letra që janë në arkivin tim, si edhe letrat nga Eqrem Çabej, Androkli Kostallari⁽²⁹⁾, Jup Kastrati, Ahmet Kondo,

²⁶ A. Bellusci, *Argalia në Frasnitë/Il telaio a Frascineto*, Shejzat, Roma, 3, 1962, 82-91; 5, 1963, 255-270; Id., *Blegtoria në Frasnitë/La pastorizia a Frascineto*, Shejzat, Roma, 1, 1964, 46-57.

²⁷ A. Bellusci, *Rilievi sulle comunità albanesi di Grecia*, Shejzat, Roma, 7, 1967, 334-350; Id., *Un arbëresh tra gli arvanites di Corinto*, Shejzat, Roma, 4, 1970, 131-147; Id. *Kërkime dhe studime ndër arbëroret të Elladhës*, Centro Ricerche, Cosenza 1994; Id., *Arbëroret-Aroanit - një popull i padukshëm*, Centro Ricerche, Frascineto 2004.

²⁸ Të parët profesorë nga Shqipëria kanë qenë Prof. Dhimitër Shuteriqi, Prof. Jup Kastrati dhe Prof. Ali Xhiku. Ishte dita 24 prill 1981. Kanë ardhur në bibliotekën time në Frasnitë dhe kanë shkruajtur në regjistër mbi këtë udhëtim-studim.

²⁹ A. Bellusci, *Vlerësimi i gjuhës dhe i kulturës arbëreshe në shkrime të Androkli Kostallarit - Letërkëmbim 1972-1992 me A. Bellusci-n*, në Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Androkli Kostallari - Figurë e shquar e gjuhësisë shqiptare, v. V, Tirana 2016, 165-189. Shih edhe A. Kostallari, *Diaspora e sotme shqiptare*, në

si edhe qindra letra që më kanë ardhur nga të gjitha trevat e Shqipërisë pas datës 13 korrik 1990, kur 25 000 vëllezër shqiptarë, mbi pesë anije, kanë zbarkuar në Brindisi, ku isha edhe unë për t'i mirëpritur ata dhe për t'i ndihmuar⁽³⁰⁾.

Më datën 13 janar 1994, Presidenti i Shqipërisë Sali Berisha, me dekret, më dha mua, arbëresh i lindur në Frascineto (Cosenza) më 15 shtator 1934, "shtetësinë shqiptare", dhe në datën 15 maj 1995 presidenti i Akademisë së Shkencave, Dr. Prof. Shaban Demiraj, m'ka dhënë doktoraturën në etnologji.⁽³¹⁾

LETËRKËMBIM (1984-1992)

Qemal Haxhihasani

i shkruan Antonio Belushit (Bellusci-t)

Letra nr. 1

Tiranë, 16. 9. 1984

"I dashur dhe i nderuar mik,

Këto ditë, duke u kthyer nga pushimet e verës, gjeta në Institut pakot me libra që patët mirësinë të më dërgoni. U gëzova shumë për to. "Lidhjen"⁽³²⁾ e shpërndava në adresat e caktuara. Biblioteka Kombëtare dhe ajo e Akademisë nuk e kanë marrë me rregull. Kishin vetëm disa numra të saj. Të gjithë ju falënderojnë për dërgimin e tyre.

Nga ana ime ju falënderoj me mirënjohje. Fillova të rilexoj (shumicën e kisha lexuar edhe më parë) ekstraktet tuaja, të cilat më japin një kënaqësi të veçantë. Bota arbëreshe dhe arbërore më rri në zemër si një fanar i ndritshëm që me hedh dritë në një tog problemesh të kulturës popullore të stërgjyshërve tanë.

veprën e cit., v. II, 147-217.

³⁰ A. Bellusci, *Lepuri në barkun e Ramiz Alisë* – Editorial, Lidhja, Cosenza, 24, 1990, 751; Id., *Bijtë e shqiptonjës fluturojnë në Evropë duke kërkuar punë dhe demokraci*, Lidhja, Cosenza, 24, 1990, 754-762.

³¹ A. Bellusci, *Domethënia e një nderimi*, Lidhja, Cosenza, 34, 1995, 1176; Shaban Demiraj, *Në shërbim të kombit shqiptar*, Lidhja, Cosenza, 34, 1995, 1177; Shyqri Galica, *A. Bellusci: Doktor i parë nderi*, Rilindja, Tirana, 17 maj 1995.

³² Lidhja/L'union, Cosenza, 10, 1984.

Kam ndërmend të kthehem ndonjëherë për të shkruar një monografi të gjatë mbi këtë temë. Kontributi juaj për të nxjerrë në pah (në dukje) traditat kulturore arbëreshe dhe arbërore (arvanitase) është mjaft i rëndësishëm për folkloristikën shqiptare.

Ju jeni shërbyesi më i zellshëm deri më tani i traditave arbërore. (Nëse ky emërtim është autentik, siç shkruani edhe ju në "Da radici arbëreshe a matrici arbërore"⁽³³⁾ vlen të bëhet i përgjithshëm në pranimet shkencore për emërtimin e arvanitasve).

Informacioni juaj në veprën e përmendur për vendbanimet dhe traditat e arbërorëve (arvanitasve) është me shumë interes. "Pastorizia a Frascineto"⁽³⁴⁾ duhet të përmbledhet në një vëllim të përbashkët si "Argalia"⁽³⁵⁾ dhe "Magia miti e credenze popolari"⁽³⁶⁾. Blegtorja ka qenë mjeshtria tradicionale e popullit tonë. Dhe aty ka shumë relikte që arbëreshët kanë sjellë nga "dheu i të parëve"⁽³⁷⁾.

"Kanunin e Lek Dukagjinit" të Gjeçovit fatkeqësisht nuk e kam në bibliotekën tonë.

E kërkova edhe ndër miq e shokë, por nuk e gjeta. As biblioteka e Akademisë nuk disponon ndonjë kopje të tepërt që të mund t'jua dërgonte. Kështu më vjen keq që nuk do të mund t'jua plotësoj dëshirën. Ju falënderoj si ju, ashtu edhe autorin e saj (Fazli Sylen), për dërgimin e vëllimit të F. Syles⁽³⁸⁾. Ju uroj shëndet dhe arritje të tjera të frytshme, për të ngritur sa më lart emrin e mëmëdheut dhe të trashëgimisë kulturore të stërgjyshërve të përbashkët.

Qemal Haxhihasani".

³³ A. Bellusci, *Da radici arbëreshe a matrici arbërore*, Lidhja, Cosenza, 10, 1984, 4.

³⁴ A. Bellusci, *La pastorizia a Frascineto/Blegtorja në Frasinë*, Cosenza 1991.

³⁵ A. Bellusci, *Il telaio nei testi originali arbëreshë/Argalia ndër tekstet origjinale arbëreshe*, Cosenza 1977. Q. Haxhihasani, *Argalia e A. Bellusci*, Nëntori, Tiranë, 10, 1977, 218-221.

³⁶ A. Bellusci, *Magia Miti e Credenze Popolari/Magjia mite dhe besime popullore*, Cosenza 1983. M. Tirta, *Magjia, Mite dhe besime popullore*, Kultura popullore, Tiranë, 2, 1983.

³⁷ Lidhja/L'unione, Cosenza, Cosenza, 11, 1984, 268.

³⁸ Fazni Syla, *Poezia popullore e kaçakëve*, Prishtinë 1980.

Letra nr. 2

Tiranë, 5. 9. 1985

"I dashur dhe i nderuar Anton,

Kam marrë librat që më ke dërguar dhe numrin 12, 1985 të "Lidhjes"⁽³⁹⁾, të cilin e shpërndava në adresat përkatëse. Ju falënderoj për dërgimin e tyre dhe njëkohësisht ju përgëzoj për lëndën e pasur dhe interesante që paraqitet në to.

Shënimet introductive të librit "Gli eredi di Skanderbeg nell'Eubea", intervistat me arbërorët e fshatrave Koskinë, Lepur, Mesor, Argjiro, Blushtë (Bellusci ?), Zaraka, Krieza dhe të 32 këngët dhe fragmentet popullore që përmbliohen aty përfaqësojnë dëshmi të rëndësishme gjuhësore, etnopsikologjike dhe folklorike me vlerë për traditat etnike që kanë mbijetuar në arbërorët e Greqisë. Edhe indeksi i përgjithshëm bibliografik që paraqitet në librin "Da Vatra Jonë a Lidhja"⁽⁴⁰⁾, me kapitujt e të dhënat përkatëse shkencore, përbën një instrument informativ me interes për studiuesit. Meqë ju jeni një nga hulumtuesit më të zellshëm të traditave folklorike arbërore dhe për mundësitë e kontakteve që keni me të gjitha sferat e tyre, do t'ju sugjeroja që, bashkë me gjurmimet shumë të dobishme që keni bërë, të zgjeroheshit diçka më shumë në kërkimin e ndonjë fragmenti apo kënge të plotë të:

- a. Baladës së vëllait të vdekur (Kostandinin e Garentinës), të Kostandinin të vogëlith, (rinjohjes burrë e grua), të murimit në Urën e Artës, të Olimpisë e Vllas (rinjohjes motër e vëlla) etj.*
- b. Ndonjë këngë e varg arbërisht për figura historike, si: Marko Boçarin, Foto Xhavellën, Kollokotronin,*

³⁹ L'Unione", nr. 12, maj 1985, në faqen e parë ka hartën gjeografike me listën e katundeve arbërore me këtë titull: "Gli eredi di Skanderbeg nell'Eubea-Documentazione linguistica e antropologica di prima mano". Jani Gjika, i lindur në Avlona (arbërisht: Kakosalesi - Atikë) në vitin 1937, vdiq në 1998-n (Shih: "Arvanon", nr.1, 1998, Athinë). Ky shkrimtar ka shkruar shumë libra mbi katundet arbërore në Eube.

⁴⁰ "Vatra Jonë/Il nostro focolare", e para revistë arbëreshe që u botua në Basilikata, që e themelova në tetor të vitit 1966 në katundin Shën Kostandin Arbëresh (Potenza), ku mbeta famullitar (1965-1973). Kanë qenë botuar katër numra deri në vitin 1970.

Bubullinën, Ali pashë Tepelenën a për ndonjë ngjarje të caktuar.

- c. Ndonjë varg për festat e vitit, si për festat e pranverës, Shën Lllazarin, Vangjelizmonë, Shën Gjergjin, Shën Mitrin, Shën Ndreun (Kërshëndellet më 25 dhjetor) etj. E marr me mend se kjo do të jetë një punë mjaft e vështirë dhe ndoshta me rezultate fare të pakta. Por, po të gjendej ndonjë element i tillë, do të ishte me një interes të veçantë për folkloristikën shqiptare. Ndonjë gjë nga *Kavo d'Oro-ja e Eubesë e ka botuar Jani Gjika në librin e tij të parë. Vëllimit të dytë të këtij autori, që më duket një nga studiuesit më seriozë të arbërorëve të Greqisë, "Oi Arvanites kai to arvanitiko tragudhi stin Elladha, 1978" i kemi bërë një recension të gjatë⁽⁴¹⁾.*

Nuk di në se i merr botimet tona rregullisht: revistën "Kultura popullore" dhe "Etnografia shqiptare" etj. Biblioteka e Akademisë jua dërgon vazhdimisht. Po të keni ndonjë nevojë lidhur me botimet tona më shkruaj. Mua më mungojnë nga revista juaj "Lidhja" numrat e fillimit, nga 1-5. Nëse do të keni mundësi të m'i dërgoni do t'ju jem shumë mirënjohës. Kështu më janë ankuar edhe bibliotekat tona, sepse nuk e marrin rregullisht revistën tuaj dhe nuk kanë prej saj një koleksion të plotë⁽⁴²⁾ (Biblioteka Kombëtare e Akademisë etj.).

Në revistën "Mondo Albanese", nr. 46-47⁽⁴³⁾, dhe në "Lidhja", nr. 12 f. 319⁽⁴⁴⁾, pashë se, me iniciativën tuaj, është

⁴¹ Kultura popullore, Tirana, 1, 1980, 199-202.

⁴² Koleksioni i plotë i revistave "Lidhja (1980-2010)" dhe "Vatra jonë" (1966-1972), të themeluara dhe të drejtuara nga unë, si edhe 12 botimet e mia etnologjike gjenden te Biblioteka Kombëtare e Tiranës dhe te biblioteka e Akademisë së Shkencave, sepse i kam dhuruar personalisht unë për studiuesit dhe për popullin shqiptar. Koleksionet janë të lidhura, nuk mendoj se i kanë prishur.

⁴³ "Ondo albanese", revistë mujore e themeluar në Piana degli Albanesi (Palermo) nga prifti arbëresh Gjergj Schirò dhe e drejtuar nga Zef Schirò Di Maggio, poet arbëresh shumë i njohur.

⁴⁴ hja/L'Unione", 12, 1985, Cosenza.

organizuar në prill të këtij viti një sesion shkencor me rastin e 100 – vjetorit të vdekjes së arbëreshit të madh Vincenzo Dorsa⁽⁴⁵⁾.

Jam shumë i interesuar që të kem kumtesat e mbajtura në këtë sesion, sidomos ato që flasin për jetën dhe veprimtarinë e tij folklorike (kumtesën tuaj dhe të V. Samarrës)⁽⁴⁶⁾. Si mund t'i fus në dorë? Po të më dërgoni një kopje të tyre do t'ju jem gjithashtu shumë mirënjohës.

Së fundmi, më lejoni t'ju shkruaj për një çështje që më ka tërhequr vëmendjen nga revista "Mondo Albanese". Në nr. 46-47 të kësaj reviste lexova shkrimin tuaj⁽⁴⁷⁾ për vdekjen e arbërorit, mikut tonë të paharruar, Jorgo Maruga⁽⁴⁸⁾.

Shkrimi më pëlqeu se që shkruar me emocione dhe saktësi. Humbja, në një moshë kaq të re, e themeluesit dhe e drejtuesit energjik të "Dialogoit" që me të vërtetë një humbje e madhe për rilindjen kulturore të arbërorëve të Greqisë dhe për botën kulturore shqiptare në përgjithësi. Shkrimet e tij plot dashuri e erudicion për traditat arbërore, informacioni aq i pasur rreth historisë, jetës, dokeve e zakoneve të tyre, përbëjnë kontribute të rëndësishme për njohjen e realitetit etnik të arbërorëve të Greqisë. Për këto kontribute Jorgo Maruga do të mbetet për ne një figurë e dashur dhe e nderuar, një shembull i lartë pune vetëmohuese në kërkimet, zbulimin dhe studimin e pasurive shpirtërore të këtyre ngulimeve.

Ju keni nënvizuar në këtë shkrim, midis të tjerash: **"Bashkëpunoi ngushtë Maruga me Qemal Haxhihasanin**

⁴⁵ Vincenzo Dorsa (1820-1885), shkrimtar arbëresh nga Frasnita.

⁴⁶ Vincenzo Sammarra, shkrimtar arbëresh nga Strigari (Cosenza), ka botuar shumë artikuj në "Lidhja/L'Unione" rreth udhëtarëve të huaj në Kalabri.

⁴⁷ A, Bellusci, *Për kujtim të arbërorit Jorgo Marouga*, Mondo Albanese, 46-47, 1985, Piana degli Albanesi.

⁴⁸ Jorgo Maruga lindi në vitin 1935 në Mandra-Elefsina (Greqi) dhe vdiq në Athinë në 19 shkurt 1985. Themeloi në vitin 1976 revistën arbërore "Dialogoi", e cila u botua deri në vitin 1984. Numri 41/1984, i i fundit, i është kushtuar arbëreshëve në Itali. Shih: Antonio Bellusci, *Jorgo Maruga, figurë e ndritur arbërore (1935-1985) – Greqinë e bënë arbërorët*, "Ura", Prishtina, 6, 2003. Bashkëpunoi dhe me revistën tonë "Lidhja". Shih dhe Antonio Bellusci, *"Aristidhi Kollja figurë e ndritur arbërore (1955-2000)-Shpirti i arbrit nuk vdes kurrë"*, Ura, Prishtinë, 5, 2003.

për botimin e veprës “Thimi Mitko”⁽⁴⁹⁾, duke e pajisur me lëndë të begatshme që vetëm ai kishte”. Për hir të së vërtetës jam i detyruar t’ju bëj të njohur se bashkëpunimi im me të ndjerin Maruga lidhur me vëllimin e Thimi Mitkos qëndron vetëm në një artikull të botuar greqisht nga folkloristi ynë Th. Mitko në revistën greke “Pandora” me titull “Disa shënime rreth Korçës”.

Kur ndodhej Maruga në Tiranë, unë i pata treguar një përkthim të këtij artikulli në shqip që e kisha në dorë. Dhe me qenë se nuk isha i sigurtë për saktësinë e përkthimit, mbasi nuk e kisha origjinalin, iu luta Marugës të më dërgonte një fotokopje të tij (I pata dhënë me këtë rast të gjitha shënimet rreth viteve dhe numrave të gazetës “Pandora” ku pati vazhduar të botohet ky artikull).

Dhe i ndjeri Maruga, me fisnikërinë që e karakterizonte, ma dërgoi pa vonesë fotokopjen e këtij material, të cilin e kam paraqitur në f. 537-555 të librit “Thimi Mitko”. Për këtë ndihmë që më dha (dërgimin e fotokopjes) unë e falënderova përzemërisht në një letër që i shkrova menjëherë.

Tjetër bashkëpunim dhe tjetër material unë nuk kam pasur nga Maruga, lidhur me përgatitjen e këtij vëllimi (Edhe ky artikull ka mbetur pa vazhdim). Në ribotimin e “Thimi Mitkos” unë do ta vë në dukje patjetër kontributin që më dha i ndjeri Maruga me fotokopjen e artikullit të përmendur, kontribut që mbeti pa u shënuar në botimin e parë vetëm rastësisht.

Më vjen keq që e bëra objekt diskutimi një çështje të tillë, po u detyrova për hir të së vërtetës. Pavarësisht nga kjo, ne ruajmë për të ndjerin Maruga të njëjtat konsiderata me të cilat u shpreha më lart. Duke pritur të më shkruani, ju dërgoj shumë të fala e shëndet.

Miku juaj **Qemal Haxhihasani** ⁽⁵⁰⁾.

⁴⁹ Haxhihasani, Thimi Mitko – Vepra, Tiranë 1981.

⁵⁰ Lidhja/L’uniono, Cosenza, revistë arbëreshe e themeluar nga A.Bellusci, Cosenza, 13, 1985, 237-338, dhe Lidhja, nr.15, 1986, 412.

Letra nr. 3

Tiranë, 19. 2. 1990

" I nderuar Anton,

Para së gjithash ju kërkoj të falur që po ju përgjigjem me kaq vonesë. Kemi marrë dy dërgesat e fundit të "Lidhjes"⁽⁵¹⁾ dhe Fjalorin frazeologjik⁽⁵²⁾, të cilat ua kam shpërndarë të adresuarve. Ju falënderojmë nga zemra për to dhe ju urojmë suksese të tilla gjithmonë në veprimtarinë tuaj kërkimore-shkencore. Fjalori frazeologjik është një vepër monumentale që hedh dritë mbi shumë probleme kulturore, ekonomike, edukative, pedagogjike, filozofike etj., që e paraqesin Arbërinë e Mesjetës me një shkallë zhvillimi mjaft të lartë.

Së bashku me Prof. M. Tirtën i kemi bërë dy recensione Fjalorit: njëren me një trajtë të zgjeruar, që do të botohet në nr. 1 të revistës "Studime filologjike" (1990) dhe një tjetër me një formë më të përmbledhur, që mendojmë se do të botohet në nr. 2 të revistës "Shkenca dhe jeta"⁽⁵³⁾. Sapo të botohen do ju dërgojmë separatet ose vetë revistat përkatëse.

Me këtë rast ju njoftoj se, pasi kam mbushur moshën ligjore të pensionit, në fillim të këtij viti jam larguar nga Instituti i Kulturës Popullore, megjithëse bashkëpunoj më të rregullisht.

Jua thashë këtë që botimet tuaja të ardhshme t'ia dërgoni një tjetër shoku në atë Institut. Për mendimin tim njeriu më i përshtatshëm për këtë qëllim do të ishte Prof. Mark Tirta, i cili është një studiues serioz dhe dashamirës i veprimtarisë suaj shkencore.

Mos harroni të më dërgoni dhe mua aty çdo gjë nga ato që do të botoni (revistën etj.).

Edhe një herë ju falënderoj me mirënjohje dhe ju uroj suksese të vazhdueshme në veprimtarinë tuaj të frytshme patriotike shkencore.

Qemal Haxhihasani ⁽⁵⁴⁾.

⁵¹ Lidhja, Cosenza, 21, 1989.

⁵² A. Bellusci, Fjalor frazeologjik i arbëreshëve të Italisë dhe të Greqisë, Centro Ricerche, Cosenza 1989.

⁵³ Shkenca dhe jeta, Tiranë, 1-2, 1990.

⁵⁴ Lidhja/L'unione, Cosenza, revistë arbëreshe e themeluar nga A.Bellusci,

Letra nr. 4

Tiranë, 2 maj 1991

"I dashur Anton,

Mbrëmë, më 1 maj 1991, ndoqa emisionin televiziv të dhënë nga Radio Televizioni i Tiranës për arbëreshët. M'erdhi mirë që në pjesën e parë të këtij emisioni ju dha fjala juve. U gëzova, sidomos për rrjedhshmërinë e gjuhës, gjallërinë dhe mendimet që shfaqët lidhur me dy revistat "Vatra jonë"⁽⁵⁵⁾ dhe "Lidhja"⁽⁵⁶⁾. Jam plotësisht në një mendje me ju për rolin që kanë luajtur këto organe për ta mbajtur gjallë dashurinë ndaj atdheut.

Pluralizmi ka hapur një epokë të re për popullin shqiptar. Pranë qeverisë sonë u ngrit Drejtoria për Emigracionin, e cila do të kujdeset për fatin e gjithë shqiptarëve që gjenden jashtë atdheut. Kuvendi i parë pluralist në Tiranë miratoi një rezolutë njaft pozitive për Kosovën. Është detyrë e çdo intelektualit të bashkërendojë veprimtarinë e tij me këtë perspektivë.

Edhe unë po përpiqem të jap një ndihmesë sado modeste në këtë kuadër. Sikurse jeni në dijeni, së bashku me Dr. Mark Tirtën, kam botuar një recensë për veprën tuaj "Dizionario fraseologico degli Albanesi d'Italia e di Grecia".⁽⁵⁷⁾ (Kujtoj se e keni marrë një kopje të separatit të këtij shkrimi).

Revista "Gjuha jonë" më kërkoi një vlerësim nga ana gjuhësore të kësaj vepre dhe unë i dorëzova një punim prej 10 faqesh për këtë qëllim (është në proces të botimit). Kam botuar 3 shkrime për jetën dhe veprimtarinë e tre folkloristëve kosovarë: Demush Shalës (në "Drita"), Zekeria Rexhës (në revistën "Kultura popullore"), dhe Anton Çetës (në revistën "Shkenca dhe jeta").

Po përgatis, po për këtë revistë të fundit, një shkrim të katërt për një talent që premtonte në fushën e folklorit kosovar, Ali Ahmetin, i cili humbi jetën tragjikisht vitin e kaluar në

Cosenza, 23, 1990, 734.

⁵⁵ Vatra jonë/Il nostro focolare (1966.1972), Shën Kostandin arbëresh, Potenza.

⁵⁶ Lidhja/L'unione, 25, 1991, Cosenza,

⁵⁷ Q. Haxhihasani, *Thezare të urtësisë popullore arbëreshe*, në *Shkenca dhe jeta*, 5, 1990, Tiranë.

një aksident automobilistik. Kam botuar në revistën "Kultura popullore" një recensë për veprën "Jeta e arvanitëve".

Ka mundësi të shkruaj edhe për biografinë e etnologut arbëror, Vangjel Lapis⁽⁵⁸⁾. (Nuk di se për ç'arsye ai ka heshtur në këto kohët e fundit).

Krahas këtyre, unë punoj, siç e dini, për një problem qendror të folkloristikës shqiptare, "Ciklin e kreshnikëve", i cili është një dëshmi monumentale e aftësive krijuese të popullit tonë, e historisë, origjinalitetit dhe trashëgimisë së tij kulturore. Në këtë rrjedhë të madhe të trashëgimisë sonë folklorike, përfshihen edhe disa tema që kanë të bëjnë me degën gjithmonë të gjelbër të traditave të shkëlqyera të vëllezërore tanë arbëreshë, të cilat hedhin dritë për dokumentimin e lashtësisë, zanafillës dhe origjinalitetit të popullit tonë në Gadishullin Ballkanik. Këtë radhë fola shumë për vetveten, duke pasur bindjen se ju e zhvilloni prej kohësh një veprimtari të tillë.

Desha t'ju vë në dukje më në fund se, si unë ashtu edhe Mark Tirta, kemi marrë revistën "Lidhja" deri te nr.21, 1989. Ju përmendët në intervistën tuaj në televizion edhe numrin 23, 1990. Prandaj do t'ju luteshim që të interesoheni dhe të na dërgoni edhe numrat e tjerë që kanë dalë pas numrit 21. Markut ia çoni në adresën e Institutit të Kulturës Popullore, kurse mua në adresën e familjes, mbasi nga marsi i vitit të kaluar kam dalë në pension.

Me dashuri e me mall, **Qemal Haxhihasani** ⁽⁵⁹⁾.

⁵⁸ Vangjel Ljapi, etnologu më i madh ndër arbërorët në Elladhë, ka jetuar në Mandra-Elefsina. Botoi shumë vepra mbi arbërorët, vepra që i kam në bibliotekë. Vepra e tij më e bukur është mbi "Vajtimet/Mitologja". tShih dhe Antonio Bellusci, *Intervistë me Vangjel Ljapi - Te vatra arbërore lepsinjote*, "Lidhja/L'Unione", 15, 1986 dhe nr. 16, 1987. V. Ljapi, *Lidhja/L'Unione*, 14, 1986 është një poezi e tij.

⁵⁹ Lidhja/L'Unione, Cosenza, revistë arbëreshe e themeluar nga A.Bellusci, Cosenza, 28, 1992, 963.

Letra nr. 5

Tiranë, 27. 6. 1991

“Shumë i dashur dhe i nderuar vëlla Anton,

Këto ditë mora 5 numrat e fundit të revistës suaj aq të dobishme “Lidhja”. U kënaqa me problemet që kemi trajtuar në të. U gëzova sidomos për rastin që ju ishte krijuar për të shkuar në Kanada dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për bashkëpunimin që kishe pasur me mëmëdhetarët e atjeshëm për vazhdimin e luftës suaj fisnike në dobi të çështjes së shenjtë të çlirimit të Kosovës sonë martire, por heroike.

Nga fillimi i korrikut (7-8) po përgatitemi për të marrë pjesë në simpoziumin e folklorit ballkanik të Ohrit. Shpresoj të takohem atje me studiuesit kosovarë të Institutit Albanologjik të Prishtinës. Dhe kjo do të jetë një nga kënaqësitë e mia kryesore në këtë udhëtim.

Duke ju falënderuar për numrat e fundit të revistës, e cila tani ka marrë dimensione të reja gjithëkombëtare, ju uroj me gjithë zemër shëndet, lumturi dhe arritje të mëtejshme në veprimtarinë tuaj shkencore atdhetare.

Qemal Haxhihasani ⁽⁶⁰⁾.

Letra nr. 6

Tiranë, 11. 9. 1991

“I dashur Ndon,

U bë një kohë e gjatë që nuk jemi parë. Ne kemi ndjekur me kënaqësi, nëpërmjet ekranit dhe shtypit periodik, veprimtarinë tuaj, sidomos lidhur me Kosovën, të cilën ju e quani më të drejtë si atdhe të dytë. Udhëtimi që bëtë në Amerikë⁽⁶¹⁾ dhe takimet që patët me bashkatdhetarët e atjeshëm na dhanë kënaqësi të veçantë.

⁶⁰ Lidhja/L'Unione, Cosenza, revistë arbëreshe e themeluar nga A.Bellusci, Cosenza, 28, 1992, 964.

⁶¹ L'idhja/L'Unione”, nr. 22, 30 tetor 1989, ku shkruajta editorialin me këtë titull: “Shqipëria mund dhe duhet të shpëtojë etninë shqiptare të shpërndarë në botë duke ju hapur problemeve”, dhe është një “Reportazh mbi shqiptarët të shpërngulur në Amerikë dhe në Kanada”(Antonio Bellusci).

Rastësisht mësova nga vajza ime, e cila kaloi pushimet në familjen e bashkëshortes në Vlorë, se në këtë qytet vinte herë pas herë kostumografja e njohur arbëreshe, motra Liçe⁽⁶²⁾, bashkë me një kolegun tuaj. Kjo, më thanë, se paska bashkëpunuar edhe me ju. Me qenë se nuk po bëheni mbarë të vini drejtpërsëdrejti në Tiranë, a do të kishit mundësi të vini ndonjëherë nëpërmjet kësaj rruge, qoftë edhe në Vlorë?

Natyrisht ne do të dëshironim ta zgjatnit udhëtimin edhe këtu në Tiranë, por në pamundësi të ndërmarrjes së një udhëtimiti të tillë, unë po të lajmëroheshja me telegram do të vija t'ju takoja në Vlorë, ku, sikurse ju thashë, kam familjen e gruas sime (Një nipi i saj, Nestor Jonuzi, është piktor i njohur në këtë qytet). Nuk di nëse ka dalë ndonjë numër i ri i "Lidhjes"? Kam marrë rregullisht numrat e saj deri në nr. 25, 1991⁽⁶³⁾. Ju falënderoj përzemërisht! Pres të më shkruani në adresën e shtëpisë.

Ju përshëndes me mall, **Qemal Haxhihasani** ⁽⁶⁴⁾.

⁶² Motra Liçia (Licia Conti) është e njohur në Arbëri dhe në Shqipëri për veprimtarinë e saj të shenjtë dhe kulturore në katundet arbëreshe, duke krijuar dhe një muze me kukulla të veshura në kostumet arbëreshe në Frasnitë. Shih: Licia Conti / Odette Marquet, *Shpirti mbretëror në veshjet e gruas arbëreshe*, Frasnita 1988. Motrat e vogla të Jesuit më 9 qershor 2018 festojnë në Tiranë 50-vjetorin e veprimtarisë së tyre në mes të popullit arbëresh, kosovar dhe shqiptar. Më kanë ftuar që të mbaj një kumtesë.

⁶³ Lidhja/L'Unione", 25, 30, 1991. Kjo revistë sot botohet çdo gjashtë muaj në Frasnitë (Cosenza). Në 30 tetor 2003 u botua "Lidhja", nr. 50, dhe gjithë koleksioni përmban 1703 faqe. "Lidhja/L'Unione", që nga numri 1(1908) deri në numrin 50 (2003), gjendet edhe në Bibliotekën Kombëtare, në bibliotekën e Akademisë së Shkencave, në bibliotekën e Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë, si edhe në Bibliotekën e Prishtinës dhe në bibliotekën e Institutit Albanologjik në Prishtinë.

⁶⁴ Lidhja/L'Unione, Cosenza, revistë arbëreshe e themeluar nga A.Bellusci, Cosenza, 28, 1992, 964.

Letra nr. 7

Tiranë, më 28.11.1991

I dashur Anton,

Kemi dëgjuar se keni botuar këto kohët e fundit gjëra të reja dhe interesante nga fusha e folklorit dhe e etnografisë. Për këtë ju përgëzojmë për zemërisht, urojmë që puna juaj pasionante në kërkim të thesarëve të etnologjisë arbëreshe e arbërore të vazhdojë me forca shpërthyeshe dhe në të ardhmen.

Ju keni energji fizike dhe shpirtërore dallgëzuese e lumturidhënëse; keni një shpirt e një mendje plot imagjinatë krijuese, të pastër e me frymëzim prej atdhetari, mendje e shpirt nga gjenet e dheut nënë, që ngjajnë me ajrin ngazëllues e ujërat e kristalta jetëdhënëse të maleve shqiptare.

Ka vite që mendojmë e diskutojmë (Q. Haxhihasani dhe M. Tirtja) se si t'i bashkojmë forcat intelektuale të profilit në kërkim e studim të thesarëve etnologjike të diasporës, si një punë shkencore krahasuese më e gjerë, një koordinim e ndërveprim për një punë të kualifikuar e komplekse. Është fjala për botimin e një korpusi etnologjik krahasues për arbëreshët e Italisë e arbërorët e Greqisë, botim tërësor trashëgimie.

Shqipëria më në fund po e shpërthen izolimin shkatërrues të jetës shoqërore e intelektuale, para nesh po duket së largu flakërima e ditëve të bardha. Atdheu ynë është në rrugën e hyrjes në gjirin e qytetërimit evropian të përparuar. Po e quajmë të nevojshme të theksojmë se sot për sot pështjellimet politike e kriza ekonomike, varfëria e rrëmuja, kanë arritur kulmin. Me sa duket, për një farë kohe, ndoshta për më se një vit, nëse nuk qetësohet gjendja, as ekonomia nuk do të gjejë rrugë mbarësie. Ndërsa koha për një ndërmarrje të tillë si kjo e jona nuk pret. Shumë gjëra të traditës treten e humbasin nga dita në ditë. Duhet kapur, studiuar e botuar sa pa u zhdukur. Ne kemi mjaft gjëra të pasqaruara për kulturën arbëreshe, pyetje që na mundojnë e që me një punë të përbashkët do t'i sqaronim e të bënim lidhjen shkencore të fijeve të këputura (faqja 1). Një arsye e fortë na shtyu t'ju drejtohem ju për të gjetur një rrugë zgjidhje për projektet tona.

Për ta sqaruar më mirë këtë është i domosdoshëm një kontakt i parë i drejtpërdrejtë me ju që t'i shtrojmë e t'i

diskutojmë problemet më imtësisht, por sa për një ide po japim disa sqarime. Do t'ju luteshim ndërkaq që të interesoni ju atje për të siguruar mundësinë e botimit të një korpusi të tillë nën patronazhin e ndonjë institucioni të atjeshëm, si "Instituti i studimeve orientale të Napolit", Universiteti i Kozencës, shoqata e arbëreshëve, ndonjë komunë arbëreshe, qendras e kërkimeve sociale – kulturore "Gj. Kastrioti Skënderbeu" etj.

Nëse e shihni të mundshëm realizimin e këtij botimi të formojmë një redaksi të përbashkët me dy specialistë nga Tirana: Q. Haxhihasani e Mark Tirtja.

Dhe dy të jenë nga pala arbëreshe: A. Bellushii dhe ndonjë tjetër që do të shihni ju të përshtatshëm.

Kjo redaksi do të paraqesë një projekt të materialeve që do të botohen në tri a katër vëllime. Vëllimi i parë të paraprihet nga një "vështrim për historinë dhe veçanësitë etnokulturore të arbëreshëve të Italisë"; të vazhdohet me prozën popullore, legjenda mitologjike e interpretimi i tyre krahasues, përralla, anekdota etj, një vëllim me proverba e gjëgjëza; një me balada e këngë histoike; një vëllim me këngë lirike e rite të motmotit etj. Dhe gjithashtu të kemi edhe aparatën shkencor që do të shoqërojë këto botime.

Çdo vëllim do të pajiset me parathënie studimore. Materialet do të jenë në gjuhën arbëreshe, duke u kthyer edhe në gjuhën e përbashkët letrare. Do të jepen shënime e referenca, p.sh. për lidhjet e çdo vlere folklorike arbëreshe me vlerat folklorike të dheut nënë. Do të ketë fjalor të fjalëve të rralla, indekse tematike të toponimeve e të tjera. Materialet bazë do të jenë materialet e botuara arbëreshe nga fillimet deri më sot. Këto do të plotësohen edhe me elementët e domosdoshëm që do të kërkohen në terren. P.sh., do të bëhen përpjekje për kërkime në terren në shërbim të historisë e veçorive etnokulturore, gjurmime në nënshtresat e mbishtresat kulturore të ndonjë legjende rreth figurave mitologjike-zanave, orëve, dragoit, kuçedrës etj.; të ndonjë ballade, si ajo e murimit, e bariut dhe bareshës, Pal Golemit etj.; të disa momenteve të repertorit të dasmës, të vajeve, të yshtjeve, festave popullore kalendarike, Shën Gjergjit, Shën Mitrit, Buzimit etj.

Ky botim mendojmë se do të formojë enciklopedinë e kulturës popullore arbëreshe dhe do të jetë me interes të madh

shkencor si për ne kënde, ashtu edhe për diasporën.

Ky punim do të evidentojë pasurinë e madhe të etnokulturës arbëreshe dhe si rrjedhim kompaktësinë etnike të diasporës shqiptare në Itali dhe në Greqi. Puna kryesore do të zhvillohet te ju (midis arbëreshëve të Italisë), prandaj, nëse do ta shihni të mundshëm realizimin e një botimi të tillë, duhet të parashikohet edhe sigurimi i një qendre pune për specialistët që do të vijjnë nga Tirana, për fjetjen, ushqimin dhe udhëtimin e tyre, natyrisht, në mënyre modeste.

Një pjesë e punës do të kryhet edhe në Shqipëri. Do t'ju luteshim të bënit një përgatitje paraprake këto ditë, në mënyrë që kur të vini në Tiranë, shpresojmë në kuvendin mbarëkombëtar, të bisedojmë edhe njëherë më me hollësi rreth kësaj çështjeje. Megjithë vështirësitë e mëdha e pengesat që mund të dalin në këtë ndërmarrje, shpresojmë se me këmbënguljen dhe vullnetit tonë do ia dalim në krye, sepse është në të mirë të padiskutueshme të unitetit të kombit dhe të progresit të tij kulturor. Së fundmi, do të dëshironim t'ju vinim në dijeni se nga studiuesit e Tiranës, ata që kanë vlerësuar dhe vlerësojnë më shumë se kushdo tjetër kontributin që kini dhënë ju në evidentimin shkencor të traditave kulturore të arbëreshëve të Italisë dhe atyre të Greqisë, jemi ne, Q. Haxhihasani e Mark Tirta. Dhe mos harroni se, "a parte la modestia", ne jemi dy specialistët më të përgatitur të këtyre fushave (etnografi dhe folklor), që garantojmë për një sukses të plotë më mirë se kushdo tjetër, edhe në të ardhmen në botimin e këtij korpusi etnologjik arbëresh. Prandaj do të dëshironim të keni parasysh edhe këtë fakt, edhe të bëni çdo përpjekje për realizimin e tij. Duke qenë edhe ju pjesëtar në botimin e këtij korpusi bashkë me ndonjë arbëresh tjetër me kapacitet, shpresojmë të realizojmë një vepër monumentale që do të zërë një vend të nderuar në historinë e etnologjisë së mbarë popullit tonë. Presim një përgjigje të studiuar dhe të përlogaritur me shkallëzim në të gjitha fazat (...). Lutemi të na përgjigjeni brenda fillimit të janarit, qoftë edhe negativisht. Duke uruar që të takohemi së shpejti në Tiranë ose te ju, ju dërgojmë përshëndetjet tona vëllazërore.

Qemal Haxhihasani ⁽⁶⁵⁾.

⁶⁵ Kjo është letra e fundit, para se të vdiste. Këtu kemi dëshirën e madhe

Letra nr. 7

Jeta e Haxhihasanit, Tiranë, më 10 prill 1992

I nderuari zoti Antonio Bellusci,

Unë që po ju shkruaj jam vajza e Qemal Haxhihasanit, Jeta. Morëm letrën tuaj të datës gjashtë shkurt 1992. Fatkeqësisht, babai im nuk arriti ta shihte pasi në muajin shkurt u nda prej nesh. Edhe ai kishte shumë dëshirë t'ju takonte dhe ndiqte me shumë interes veprimtarinë tuaj. Edhe unë ndonëse kam mbaruar studimet këtu në Tiranë për Kimi, dhe tani punoj në Bibliotekën Kombëtare po me këtë profil, lexoj me ëndje revistën tuaj "Lidhja". Ju na shkruani se keni në plan të vini në Shqipëri. Shpresojmë se do të mund t'ju takojmë këtu në Tiranë. Nëse keni ndonjë kërkesë na shkruani në të njëjtën adresë dhe ne do të mundohemi t'ju plotësojmë me kënaqësi.

Me respekt, Jeta Haxhihasani ⁽⁶⁶⁾.

Përfundim

Mbi vdekjen e Q. Haxhihasanit kam shkruajtur disa mendime⁽⁶⁷⁾. Si Androkli Kostallari ashtu edhe Q. Haxhihasani, para se të na largoheshin nga kjo jetë, më kanë futur në shpirt dhe në zemër amanetet e tyre më të bukura dhe më të pathënshme. Në një kohë ateiste dhe të mbyllur, këta dy njerëz të mëdhenj kanë mbajtur me mua gjithmonë një lidhje shpirtërore dhe vëllazërore sa s'mund të shkruhet. Por kjo ndihet te zemra. Dhe kjo lidhje ka një fuqi të madhe edhe sot, kur çdo njeri mbyllet dhe biedon me vetveten.

dhe dashurinë për kulturën popullore arbëreshe-arbërore, po edhe për një bashkëpunim kulturor midis shqiptarëve dhe arbëreshëve. Në Shqipërinë e sotme, me liri e me demokraci, ku janë këta njerëz të mëdhenj që të dëshmojnë ndjenjavëllazërore bashkëpunimi? Ne sot punojmë në rrugën e të pavdekshmit Qemal Haxhihasani, dhe shpresojmë ditë më të mira për ne, për popullin dhe për kombin.

⁶⁶ Lidhja/L'unione, Cosenza, revistë arbëreshe e themeluar nga A.Bellusci, Cosenza, 28, 1992, 964.

⁶⁷ A. Bellusci, Lidhja/L'unione, Cosenza, revistë arbëreshe e themeluar nga A.Bellusci, Cosenza, 27, 1992, 932.